

GJYKIMET PRANË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

KORRIK - DHJETOR 2022



PËRMBAJTJA

TRANSFERIMI I RASTEVE TEK TRUPI GJYKUES

RASTI NË DHOMËN E SHKALLËS SË PARË

RASTI NË DHOMËN E APELIT

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) i monitoron proceset gjyqësore që zhvillohen pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës. FDHK publikon buletine dhe analiza që lidhen me punën e Dhomave të Specializuara, të cilat i shërbejnë publikut të gjerë për të qenë më të informuar mbi ecurinë e çështjeve gjyqësore.

Në këtë buletin janë paraqitur informatat e përgjithshme mbi ecurinë e gjykimeve para Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) përgjatë periudhës gjashtë mujore korrik - dhjetor të vitit 2022.

Aktualisht, pranë DHSK janë duke u trajtuar katër (4) raste, Prokurori kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve; Prokurori kundër Pjetër Shalës; Prokurori kundër Salih Mustafës; dhe Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.



TRANSFERIMI I RASTEVE TEK TRUPI GJYKUES

Prokurori kundër Pjetër Shalës

Pjetër Shala, pjesëtar i UÇK-së, akuzohet nga prokuroria për krime të luftës për periudhën midis 17 maj të vitit 1999 dhe 5 qershor të vitit 1999, kundër personave që u mbajtën të ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës, Shqipëri.

Procedura paraprake kundër Shalës ka përfunduar dhe më datën **21 shtator të vitit 2022 dosja është transferuar për gjykim tek trupi gjykues.**

Gjatë periudhës korrik - dhjetor të vitit 2022, trupi gjykues ka mbajtur tre (3) seanca mbi ecurinë e çështjes përgatitore për gjykim, që do thotë se shqyrtimi i provave ende nuk ka filluar. Njëra prej këtyre seancave ka qenë e mbyllur për publikun. Në këto seanca palët përgatiten për shqyrtim kryesor.

I pandehuri Shala që nga arrestimi i tij në mars të vitit 2021 ende ndodhet në paraburgim.

Për krimet e ngjashme që kanë ndodhur në veri të Shqipërisë në të kaluarën janë zhvilluar edhe dy procese gjyqësore në Kosovë: Prokurori kundër Xhemshit Krasniqit dhe Prokurori kundër Sabit Gecit dhe të tjerëve, ku gjashtë persona janë dënuar për krim të luftës kundër popullatës civile nga gjyqtarët e misionit të EULEX-it.

Prokurori kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, të gjithë me pozita të larta në UÇK, akuzohen nga prokuroria për krime luftime dhe për krime kundër njerëzimit, për periudhën prej marsit të vitit 1998 deri në shtator të vitit 1999, në disa vendndodhje në Kosovë dhe në Shqipëri, të cilat pretendohet të jenë kryer nga anëtarë të UÇK-së kundër qindra civilëve dhe personave që nuk merrnin pjesë në luftime.

Gjatë periudhës korrik - dhjetor të vitit 2022, janë mbajtur katër (4) konferenca mbi ecurinë e çështjes, një prej tyre para trupi gjykues. Në këto konferenca janë diskutuar çështjet me rëndësi për palët, ku ndër të tjera janë diskutuar ndryshimet e aktakuzës, hetimet e prokurorisë dhe nxjerrja e materialeve, ecuria e hetimeve të mbrojtjes, kërkesat për mundësitë hetimore unike, parashtrimet e ekipeve të mbrojtjes për mos nxjerrjen e materialeve në tërësi nga ana e prokurorisë, si dhe lidhur me redaktimet e tepërta në deklaratat e dëshmitarëve nga ana e prokurorisë.

Procedura paraprake kundër të pandehurve ka përfunduar. **Në datën 15 dhjetor të vitit 2022 dosja është transferuar për gjykim para trupi gjykues** dhe me datën 16 dhjetor të vitit 2022 është mbajtur seanca e parë mbi ecurinë e çështjes pranë trupit gjykues.

Të pandehurit u arrestuan në fillim të nëntorit 2020 dhe që atëherë gjenden në paraburgim.

RASTI NË DHOMËN E SHKALLËS SË PARË

Prokurori kundër Salih Mustafës

Salih Mustafa, komandant i njësitit BIA të UÇK-së, akuzohet për krimet e luftës, të cilat dyshohet se janë kryer gjatë muajit prill të vitit 1999 në fshatin Zllash/Zlaš të Komunës së Prishtinës/Priština.

Gjatë periudhës korrik - dhjetor të vitit 2022, para trupit gjykues janë mbajtur tre (3) seanca gjyqësore në të cilat palët i kanë paraqitur fjalët përfundimtare. Shqyrtimi kryesor ka përfunduar brenda periudhës një vjeçare, pas mbajtjes së 52 seancave, ku janë dëgjuar 29 dëshmitarë dhe është bërë administrimi i provave materiale.

Në datën 16 dhjetor të vitit 2022, trupi gjykues e shpalli aktgjykimin e parë për krimet e luftës para kësaj gjykate, në rastin Prokurori kundër Salih Mustafës. Gjykata e ka dënuar Salih Mustafën për veprat penale të ndalimit arbitrar, torturë dhe vrasje të paligjshme si krim të luftës dhe e ka dënuar me dënim unik prej 26 viteve burgim, kurse për arsye ligjore është liruar për veprën penale të trajtimit mizor.

Që nga arrestimi i Mustafës në shtator të vitit 2020, i njëjti ende gjendet në paraburgim.

RASTI NË DHOMËN E APELIT

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj janë akuzuar për vepra penale kundër rendit publik dhe pengimit të administrimit të drejtësisë dhe administratës publike.

Në datën 18 maj të vitit 2022 trupi gjykues i shkallës së parë të pandehurit i ka shpallur fajtor për veprat penale: shkelja e fshehtësisë së procedurës, frikësim gjatë procedurës penale, dhe pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare dhe i ka dënuar me dënim unik prej 4 vite e 6 muaj burgim.

Ekipe të mbrojtjes e kanë apeluar këtë aktgjykim brenda afatit të paraparë dhe kjo procedurë ka kaluar në shkallën e dytë.

Gjatë periudhës korrik - dhjetor të vitit 2022, në këtë rast janë mbajtur tre (3) seanca, të cilat kanë përfshirë një (1) konferencë para apelit në muajin korrik të vitit 2022 dhe më pas dy (2) seanca të apelit në muajin dhjetor të vitit 2022. Në datat 1 dhe 2 dhjetor të vitit 2022 u mbajtën seancat e apelit, ku ekipet e mbrojtjes u deklaruan rreth dosjeve të tyre të apelit.

Tani pas parashtrimeve të fundit të palëve në apel, kolegji duhet të vendos brenda 90 ditëve dhe të merr vendimin e shkallës së dytë.

GJETJET E FDHK:

Stafi i cili angazhohet në kuadër të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës duhet të sigurohet që do të kontribuoj për një periudhë më të gjatë kohore dhe nuk duhet të ketë dorëheqje të shpeshta pasi që rastet e krimeve të luftës janë mjaft voluminoze dhe kërkojnë kohë që persona të ri të familjarizohen me rastet. Që nga shtatori i vitit 2016 vetëm në krye të Zyrës së Prokurorit të Specializuar janë emëruar katër (4) prokurorë special, dy (2) prej të cilëve si ushtrues detyre.

Dënimi prej 26 viteve burgim kundër Salih Mustafës duke u krahasuar me praktikën e më hershme të TPNJ dhe proceseve gjyqësore në Kosovë, paraqet një standard të ri të sanksionimit duke dhënë dënim më të lartë. Me publikimin e aktgjykimit duhet parë nëse gjykata ka përdorur ose jo ligjin më të favorshëm penal me rastin e shqiptimit të dënimit.

Me rastin e shpalljes së aktgjykimit gjykata ka paralajmëruar se do të lëshojë një urdhër për zhdëmtim të viktimave. Ky është vendimi i parë në praktikën gjyqësore për krimet e luftës në Kosovë ku gjykata me rastin e shpalljes së aktgjykimit e lëshon një urdhër të tillë, i cili e detyron të dënuarin që ta dëmshpërblejë ose kompensojë viktimën.

[Këtu](#) mund ta lexoni buletin për periudhën janar - qershor të vitit 2022.



Ky publikim përkrahët financiarisht nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës përmes projektit "Avancimi i procesit të pajtimit përmes qasjes përfshirëse dhe holistike ndaj ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë" nga organizata "National Endowment for Democracy" përmes projektit të quajtur "Promovimi i dialogut dhe të kuptuarit historik".

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës dhe organizatës "National Endowment for Democracy".